

Emri i Lëndës : Morali Islam							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ISC 341	B	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	5.00
Lektori		Oltion Kola, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip, Anglisht, Turqisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Ne këtë lende shpjegohen tema te ndryshme te moralit islam te cilat nxisin studentin ne formimin e tij dhe ne kontributin e tij në shoqërinë bashkëkohore.					
Objektivat		Trajtimi i veçorive personale që duhet të posedojë një njeri i moralshëm. - Të mësohen detyrimet që ka një person kundrejt familjes, të afërmeve dhe shoqërisë.					
Konceptet Kryesore		1. Morali 2. Etika 3. Edeb 4. Njeriu ideal 5. Tarikul Mustekim 6. Iman 7. Teslim/ dorëzim					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Morali, Përkufizimi dhe Objektivat e tij. Në këtë leksion do të jepen përkufizime të përgjithshme lidhur me termat të cilat do të përdoren n lëndën Bazat e Moralit Islam. Terma të tillë si ahlak, moral, edeb, etike, sjellje e mire, diferenca midis termave halk dhe huluk. (Buykcelebi, fq. 1-25)						
2	Veçoritë e njeriut ideal/njeriu të përsosur: në këtë javë do të trajtohen tema të tilla të cilat kontribuojnë që studentët aftësohen me posedimin e trajtimit të veçorive personale që duhet të posedojë një njeri i moralshëm. Të jenë shembull ideal për shoqërinë ku jetojnë dhe më gjerë. (Buykcelebi, fq. 25-50)						
3	Vullneti, qëllimi i mirë, sinjeriteti: një ndër çështjet më të diskutuara përsa i përket njeriu si krijesë është vullneti, dëshira e tij apo mundësia për të zgjedhur të mirën apo të keqen, të duhurën apo të gabuarën. Duke qenë e tillë është shumë e rëndësishme që këtë vullnet duhet ta ndërthurë me besimin e tij që të arrijë ta përdorë sipas etikës dhe moralit Islam. (Buykcelebi, fq. 50-85)						
4	Pendesa dhe të kërkosh falje (Teube dhe istigfar): Termat Teube dhe istigfar janë ndër më të njohurat për besimtarin dhe ndër më të rëndësishmet gjithashtu. Prandaj në këtë leksion do të qëndrojmë në mënyrë të detajuar mbi këto terma duke synuar që studenti të përfitojë perceptimin fetare të tyre.						
5	Rruga e mesme, drejtësia dhe rruga e drejtë: Islami është përfaqësimi i rrugës së mesme. Në këtë leksion do të qëndrojmë mbi termin “tarikul Mustekim” rruga e mesme e cila është e gjithë epiqendra e Islamit. (Buykcelebi, 85-100)						
6	Guximi, trimëria dhe sakrifica: ndër moralet e besimtarit janë edhe guximi, trimëria dhe sakrifica të cilat ai i shpalos nga vetja e tij për të qenë një besimtar i dobishëm për mbarë shoqërinë. Kjo do të trajtohet në terma të përgjithshëm rreth: “shexhaa”, “batal” “ithar”. (Buykcelebi, fq. 100-125)						
7	Falja, toleranca: ndër çështjet e rëndësishme janë edhe falja dhe toleranca edhe ne momentet kur ne jemi të aftë të hakmerremi për padrejtësitë apo gabimet që na janë bërë. Për këtë arsye do të shtjellojmë dhe analizojmë jetën e profetit Muhamed në aspektin e të qenurit tolerant dhe falës ndaj të tjerëve. (Buykcelebi, fq. 125-150)						
8	Provimi gjysmë final						
9	Iman (Besimi) dhe jakîn: besimi është çështja kryesore për një individ. Të kërkojë rrugë të ndryshme në mënyrë që të forcojë besimin e tij është detyrë e çdo besimtari. Për këtë arsye do te shtjellomë disa terma kyç si “hakkal jakin” “ajnal jakin”, iman etj. (Buykcelebi, fq. 150-190)						

10	Dorëzimi, mbështetja tek Allahu dhe tefuiz: termat kryesore në këtë leksion do të jenë “teslim” “muslim” teufiz, tevekkul, të cilat do të na japin një këndvështrim ndryshëm në raportin ndaj Zotit. (Buykcelebi, fq. 190-210)
11	Zemërgjerësia dhe Ëthar: ndër karakteristikat kryesore të besimtarin janë zemërgjerësia, vetë sakrifikimi dhe bujaria. Lidhur me këtë termat kryesore janë xhud, xhevad, ithar, etj. (Buykcelebi, fq. 210-225)
12	Marrëdhëniet familjare dhe mirësia për prindërit: ndër më të rëndësishmet në islam janë marrëdhëniet fëfësnore dhe mirësia për prindërit. Lidhur me këtë do të analizojmë thëniet profetike dhe ajetet Kuranore të cilat na tregojnë qartazi vlerën dhe peshën që këto mbartin. (Buykcelebi, fq. 225-240)
13	Morali shoqëror, marrëdhëniet me komshinjtë dhe përshëndetja: ndër çështjet e rëndësishme që bëhen shkak për të fituar kënaqësinë e Zotit janë edhe morali shoqëror, marrëdhëniet me komshinjtë dhe përshëndetja paqësore me njerëzit. Lidhur me këtë do të analizojmë hadithet profetike të cilat na flasin për këtë të vërtetë. (Buykcelebi, fq. 240-255)
14	Morali profesional, ihsani dhe drejtësia: drejtësia është nga atributet hyjnore të cilë Allahu e dëshiron edhe për njerëzit. Prandaj i nxit ata të jenë të drejtë dhe besnikë mbi sipërfaqen e tokës. (Buykcelebi, fq. 255-270)
15	Falënderimi: njeriu duhet të jetë falënderues në çdo situatë dhe për çdo gjë. Duke analizuar hadithet dhe ajetet e ndryshme shprehim të paraqesim për studentët një këndvështrim më të qartë mbi rëndësinë e këtij morali. (Buykcelebi, fq. 270 -295)
16	Final Exam
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Ismail Buykcelebi, Living in the shade of Islam, the Light, New York, 2005.	
Referenca të tjera	
•	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të aftësohen me posedimin e trajtimit të veçorive personale që duhet të posedojë një njeri i moralshëm.
2	Studentët do të mësohen me detyrimet që ka një person kundrejt familjes, të afërmeve dhe shoqërisë.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	2	20	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	2	8	16
Gjysmë finale	1	5	5
Provimi final	1	8	8
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			121
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.84
ECTS			5.00